

FJALA E DEPUTETIT FATMIR MEDIU

E ENJTE 31 MARS 2022

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Do të vazhdoj mendimin e zonjës Bushka, sepse ndaj të njëjtin qëndrim me të për një çështje kaq të rëndësishme siç është siguria kombëtare. Shpresoj që, kur të diskutojmë për çështje të sigurisë kombëtare, kjo sallë e Kuvendit të mos jetë bosh, por plot, jo vetëm me njerëz, por edhe me mendime, sepse çështjet e sigurisë janë të një interesi jetik për vendin dhe ne si deputetë, si përfaqësues të qytetarëve, por edhe të interesit kombëtar, duhet të jemi shumë të thelluar në diskutimet që kanë të bëjnë me sigurinë tonë kombëtare. Më lejoni ta filloj diskutimin në mënyrë personale.

Sot më jepet rasti publikisht të falenderoj një mik të madh të Shqipërisë dhe të shqiptarëve, gjeneralin Jim Jones, ish-komandanti suprem i NATO-s, i cili në vitet 2005-2007 ishte nga zërat më të fuqishëm të mbështetjes së Shqipërisë për të marrë ftesën për anëtarësim në NATO, jo vetëm thjesht nga shape apo nga Brukseli, por duke ardhur, duke e njohur, duke e prekur dhe duke punuar me përfaqësuesit e Forcave tona të Armatosura dhe njëkohësisht duke vlerësuar kontributet e tyre misionet në paqeruajtëse! Po ashtu ai u kthye në një zë të fuqishëm të diplomacisë ushtarake në Bruksel dhe në Uashington për mbështetjen e Shqipërisë. Më tej si National Security Advisor i Presidentit Obama, një administratë e re pas Presidentit Bush, i cili dha mbështetjen më fantastike për Shqipërinë dhe Kosovën këtu në Tiranë me vizitën e tij, ka qenë një nga zërat kryesor për të mbështetur më tej anëtarësimin e Shqipërisë në NATO në vitin 2009.

Ne, të paktën në traditën tonë, dimë të falenderojmë dhe t'i mirëpresim miqtë. Unë ndiej kënaqësi që sot ne rivendosim një marrëdhënie, e cila nuk është thjesht e planit personal, por është sa politike, ushtarake aq edhe në interes të sigurisë sonë kombëtare. Gjenerali Jones është një nga njerëzit më të angazhuar jo vetëm thjesht në politikën e sigurisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por në politika që kanë të bëjnë edhe me sigurinë e rajonit tonë, duke e konsideruar këtu edhe konfliktin që po zhvillohet në Ukrainë, pasojat që ai ka nga ndikimet e Rusisë dhe sidomos edhe nga ndikimi i Kinës. Është një nga iniciatorët e iniciativës së Tre Deteve, Baltik, Detit të Zi dhe të Mesdheut, ku ne shqiptarët duhet të gjejmë veten tonë, sepse është një nga iniciativat më të rëndësishme që ka të bëjë me zhvillimin infrastrukturor Veri-Jug, ka të bëjë me zhvillimin teknologjik dhe me zhvillimin e burimeve energjetike, projekte, të cilat do të financohen nga vendet e Europës Qendrore, por edhe Juglindore, me mbështetjen e të gjitha administratave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përfshirë këtu të presidentit Obama, Biden dhe Trump, ku të gjithë janë bërë një, republikanë dhe demokratë, për të mbështetur këto nisma shumë të rëndësishme, për të garantuar sigurinë dhe një marrëdhënie të qenësishme, jo vetëm atë që ishte Europa Perëndimore, por me të gjithë Europën, e cila ka qenë në ndikime të tjera për 45 vjet.

I thashë të gjitha këto, sepse besoj se të gjithë duhet të kemi votuar për këtë marrëveshje. Këtu nuk hyn procedura, kolegja ime e shpjegon shumë herë më mirë, për shkak të pozicionit dhe profesionit që ka, por nisur nga fakti si një nga njerëzit e angazhuar për një kohë të gjatë me çështjet e sigurisë, mendoj se është e jashtëzakonshme dhe jetike për Shqipërinë që të miratojë një marrëveshje të tillë. Vlerësimi i sigurisë kibernetike është një emergjencë kombëtare. Ndoshta kemi dëgjuar pak për këtë, por duhet të kuptojmë që është një nga momentet më të rëndësishme për ta vlerësuar, sepse e tillë ka qenë edhe kërkesa e NATO-s dhe, duke qenë vend anëtar i saj, ne kemi përgjegjësinë për të ecur me të njëjtin ritëm me vendet e tjera anëtare për sigurinë kibernetike. Këtë nuk duhet ta shohim vetëm në aspektin se jemi vend i NATO-s, por në interesin tonë, sepse ne duhet të garantojmë të gjithë infrastrukturën kritike, ekonominë dhe biznesin nga këto sulme.

Marrëdhënia më e mirë është që të ecim në një vlerësim të saktë të sigurisë kibernetike që kemi dhe garantimin e ndërtimit të një strukture të qëndrueshme nga çdo lloj sulmi të mundshëm kibernetik, sidomos duke parë kontekstin rajonal sot me influencën ruse në shumë vende të Ballkanit, si në Serbi dhe në Republika Srpska, e cila duhet të na bëjë të vetëdijshëm, të dëgjohemi dhe të shikojmë realisht problemet në rajonin tonë dhe jo të jemi kalimtar ose vëzhgues të ngjarjeve të rajonit. Kam bindjen se si vend anëtar i Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara po përpiqemi të bëjmë atë që është më e mira, por besoj që këtu duhet të marrim një peshë edhe ne, si Kuvend i Shqipërisë. Prandaj dua të theksoj fort se, në qoftë se ne ecim me bindjen se kemi një rol në rajonin e Ballkanit, ne duhet, përfundimisht, të ndërtojmë marrëdhënien më të qartë të partneritetit me partnerin tonë strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, jo vetëm në fushën diplomatike, por edhe në fusha të tjera të rëndësishme të sigurisë, të industrisë ushtarake dhe sidomos të sektorit energjetik. Prandaj unë do të jem në mbështetje të çdo nisme dhe iniciative që vjen, pavarësisht nga krahu politik, e cila forcon marrëdhëniet tona me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në kontekstin e sotëm rajonal, europian dhe botëror, marrëdhëniet e shqiptarëve me Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet të njohin një shkallë tjetër marrëdhënieje dhe vlerësimi, në mënyrë që ne të jemi partnerë realë, të bëjmë atë që na takon dhe atë që na kanë besuar. Investimet në fushën e sigurisë kibernetike, siç e thashë, janë domethënëse për Shqipërinë. Gjej rastin të vlerësoj mbështetjen dhe financimin e komandës amerikane në Europë për Ministrinë e Mbrojtjes, pikërisht, në ndërtimin e strukturave për mbrojtjen kibernetike. Po ashtu, dua të vlerësoj edhe ndërtimin e bazës së komandës operacionale të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri. Këto janë sinjale të një marrëdhënieje të qenësishme dhe të rëndësishme, të cilat vijnë si vazhdë e marrëdhënieve që kemi pasur historikisht, sepse këto marrëdhënie nuk kanë filluar sot, por kanë kohë. Një nga marrëveshjet që e ka votuar ky parlament, për të cilën kemi qenë koshinetë të gjithë bashkë kur e kemi votuar, është marrëveshja me Lockheed Martin, për vëzhgimin e hapësirës detare, por nuk do ta linim me aq, do të vazhdonim akoma më tej, me vëzhgimin e hapësirës detare, tokësore dhe atë ajrore. Kjo marrëveshje bëhet për të pasur një sistem të integruar, i cili na vlen jo vetëm nga pikëpamja ushtarake, por edhe nga ajo e interesit ekonomik dhe interesave të tjera të sigurisë tonë kombëtare.

Ka investime të tjera të rëndësishme, të cilat duhet të zhvillohen në sektorin energjetik. Po ashtu, dua të vlerësoj maksimalisht marrëdhënien që është vendosur me Exxon Mobil për sa i përket gazit të lëngshëm, sepse pavarësia energjetike, sidomos pas vënies në funksion të TAP-it, të korridorit të jugut

energjetik të Europës, është jashtëzakonisht e rëndësishme. Ky është një investim i bërë në kohën e zotit Berisha, i cili sot duhet të kthehet në një nivel tjetër të marrëdhënies së kuptimit të vlerësimit për gjithsecilin, pavarësisht nga krahët politikë që kemi, sepse i shërben interesave të vendit tonë. Kolegë të nderuar deputetë, Dua t'ju them se marrëdhënia me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në fushën e sigurisë, energjisë dhe teknologjisë për Shqipërinë janë jetike, sidomos duke marrë në konsideratë atë çfarë po ndodh në Ballkan dhe në Ukrainë.

Prandaj, uroj që rezultati i votimit, edhe pse ka përfunduar, të ketë qenë një rezultat, ku të gjitha krahët të dinë të tregojnë se kanë tejkaluar veten e tyre dhe kanë bërë diçka që i shërben interesit të vendit. Ne kemi nevojë për partnerë realë, kemi nevojë për miq, si gjenerali Xhons, kemi nevojë të vlerësojmë marrëdhënien me kompani reale me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e tjera të Bashkimit European. Në fushën e sigurisë, marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për ne shqiptarët, janë të pazëvendësueshme, qoftë si vend, por edhe në pozicionin që kemi si vend anëtar i NATO-s. Faleminderit!